


Manual

i Instrumentit të Planifikimit Financiar në version excel IPF



Planifikimi Financiar Afatmesëm i Qeverisë Vendore në kontekstin Shqiptar - 2013



Planifikimi Financiar Afatmesëm i Qeverisë Vendore në kontekstin Shqiptar

Manual i Instrumentit të Planifikimit Financiar në version excel IPF

Ky publikim është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)

Përgatitur nga:

Prof Stefan Pfaeffli & Alex Loetscher

University of Applied Sciences and Arts, Lucerne Business School, Switzerland

Mbështetur nga:

Valbona Karakaçi, Voltana Ademi, Elvin Hoxha

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

HELVETAS Swiss Intercooperation, Shkodër, Albania

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC.

Publikuar nga:

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI) Albania

Copyright © HSI Albania

Rr. Oso Kuka, Nr. 11,

4000 Shkodër, Albania

www.dldp.al



Të nderuar kryetarë të njësive të qeverisjes vendore dhe menaxherë vendorë

Me kënaqësi, mbështes iniciativën e Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dlp), i financuar nga Agjencia Zviceriane për Bashkëpunim dhe Zhvillim (SDC), për të botuar manualin “Planifikimi Financiar Afatmesëm i Qeverisë Vendore”.

Procesi i decentralizimit gjatë këtyre viteve të fundit ka njohur arritje të rëndësishme. Shumë funksione dhe kompetenca për shërbime dhe punë publike, janë transferuar dhe vazhdojnë të transferohen në pushtetin vendor. Decentralizimi fiskal, ka qenë një nga komponentët më vitalë dhe të rëndësishme të kësaj reforme. Janë transferuar në nivel vendor, taksa të rëndësishme të cilët kanë ndikuar jo vetëm në rritjen e të ardhurave vendore por ato kanë shërbyer dhe shërbejnë si instrumente efikase për të bërë politika fiskale vendore, që njëherësh janë politika zhvilluese lokale.

Në përputhje me eksperiencat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian, janë miratuar ligje dhe akte nënligjore për taksat dhe tarifat vendore, të cilat kanë rritur në mënyrë substanciale autonominë fiskale dhe financiare të qeverisjes vendore.

Një ndër sfidat e rëndësishme të financave publike në vendet në tranzicion është, mbledhja dhe përdorimi me ekonomi të ardhurave nga tatimet dhe taksat, proces që po merr gjithnjë e më shumë rëndësi edhe në vendin tonë.

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, përcakton qartë procesin dhe procedurat e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të institucioneve dhe njësive publike, të pushtetit qendror dhe atij vendor.

Ky manual, u shërben njësive të qeverisjes vendore si udhëzues për hartimin e programeve buxhetore afatmesme të tyre.

Jam i bindur, që ky manual shkon në të njëjtin drejtim me investimet e bëra nga Qeveria Shqiptare, për modernizimin e administratës vendore dhe lehtësimin e punës së menaxherëve vendor.

Ky manual, është një instrument i rëndësishëm për t’u ardhur në ndihmë punonjësve të financës dhe menaxherëve vendorë për të thelluar dhe konsoliduar dijet dhe njohuritë e tyre në buxhetimin vendor, me synim rritjen e eficensës dhe efektivitetit të përdorimit të të ardhurave publike.

Edhe një herë, dua të falenderoj Qeverinë Zviceriane për ndihmën e dhenë dhe që vazhdon të japë në lidhje me modernizimin e financave vendore.

Ridvan BODE



1. Hyrje

Që nga viti 2009 qeveritë vendore në Shqipëri, janë të detyruara të përgatisin një buxhet afat-mesëm bazuar në ligjin 9936 për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Ligji kërkon që me anë të buxhetit afat-mesëm të zbatohet një politikë e integruar dhe një plan financiar për një afat kohor tre vjeçar. Buxheti afat-mesëm konsiderohet si ndërlidhja midis planit strategjik afat-gjatë brenda një harku kohor prej dhjetë ose më shumë vitesh dhe buxhetit vjetor.

Zakonisht buxhetet e enteve publike kanë një horizont të kufizuar një-vjeçar. Disavantazhi i buxheteve një vjeçar është orientimi i tyre afat-shkurtër. Zakonisht në buxhetet afat-shkurtra, ka një fleksibilitet të vogël në shpërndarjen e burimeve të kufizuara në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit. Në mënyrë që buxheti të bëhet më largpamës u përdor orientimi buxhetor afat-mesëm si një plotësim i buxhetit vjetor. Shtrirja planeve buxhetore afat-mesme edhe në qeveritë vendore Shqiptare ishte një ide e mirë, megjithatë qeveritë vendore shqiptare nuk ishin ende gati për të përgatitur buxhete afat-mesme të përshtatshme.

Projekti i decentralizimit dhe zhvillimit lokal dldp, i financuar nga Agjencia Zviceriane për Bashkëpunim dhe Zhvillim SDC dhe e zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation, ka filluar të mbështesë decentralizimin dhe zhvillimin lokal në Shqipërinë e veriut që në vitin 2006. Në vitin 2010, kur projekti hyri në fazën e dytë të tij, ndihma ndaj qeverisjes vendore dhe ndaj menaxhimit të financave publike u zgjerua.

Nga faza e parë e programit dldp (Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim) pati mundësinë të ndërtonte një eksperiencë domethënëse dhe gjithëpërfshirëse në mbështetjen e hartimit të planeve të zhvillimit strategjik SDP, në nivelin e qeverisë vendore. Metodologjia e dldp për hartimin e SDP-ve karakterizohet nga një përqasje e forte pjesmarrje. Megjithatë metodologjia ekzistuese e planifikimit, e përdorur gjatë fazës së parë, kishte nevojë për përmirësime të mëtejshme dhe pas këtij përmirësimi mund të fillonte zbatimin e metodologjisë në një zonë më të gjerë të komunave në Shqipëri. Përveç mbështetjes për planin e zhvillimit strategjik, dldp hartoi edhe një metodologji për buxhetin afat-mesëm në bashkëpunim me ekspertët Shqiptar. Materialet e trajnimit janë hartuar dhe aktualisht, njësitë e qeverisjes vendore (NjQV-të) përkatëse po trajnohen në planifikimin e zhvillimit strategjik dhe buxhetit afat-mesëm. Që nga viti 2010, HSLU ofron rregullisht mbështetje tematike dhe logjistike për dldp.

Nga bashkëpunimi ekzistues midis HSLU dhe Helvetas Swiss Intercooperation dhe ekspertëve vendor të dldp-së, lindi ideja e lehtësimit të procesit të hartimit të buxhetit afat-mesëm me anë të njëinstrumentielektronik të planifikimit

financiar IPF. Ky instrument elektronik planifikimi duhet të jetë me kosto të ulët, i bërë enkas për kontekstin Shqiptar dhe i aplikueshëm në çdo komunë Shqiptare. Për më tepër duhet të hartohet në përputhje me rekomandimet buxhetore ndërkombëtare dhe duhet të respektojë parashikimet ligjore të Shqipërisë mbi hartimin e buxhetit. HSLU dhe dldp financuan së bashku Instrumentin e Planifikimit Financiar – IPF. Ekspertët e HSLU-së dizenuan dhe programuan softwar-in bazuar në programin excel. Ekspertët lokal të dldp-së testuan softwar-in në 11 njësi vendore partnere në Qarkun Shkodër dhe Qarkun Lezhë të dldp-së, në vjeshtën e vitit 2011 dhe gjatë vitit 2012 duke dhënë komente të vlefshme mbi mënyrën si duhet rregulluar IPF-ja në masën sa më optimale për nevojat e Shqipërisë. Për më tepër ata e përkthyen IPF-në në gjuhën Shqipe. Në rastin kur kishte pyetje të hapura u konsultuan Ekspertët e Ministrisë së Financave. IPF-ja është e përfshirë në paketën PSZHePBA të dldp-së, ku standartet “PSZH” kanë kuptimin e planit të zhvillimit strategjik ndërsa “PBA” ka kuptimin e programit buxhetor afat-mesëm dhe “e” i referohet IPF-së elektronike.

Ky manual do të ndihmojë zyrtarët shqiptar të hartimit të buxhetit të NjQV-ve të vënë në përdorim IPF-në. Megjithatë manuali nuk zëvendëson trajnimin e nevojshëm mbi buxhetin afat-mesëm dhe mbi përdorimin e IPF-së.

Shpresojmë që IPF-ja do të përdoret gjerësisht në Shqipëri duke lehtësuar procesin e hartimit të buxhetit afat-mesëm dhe duke e bërë atë më të besueshëm dhe transparent. Krijuesit e IPF-së dëshirojnë të falenderojnë të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre në realizimin e IPF-së. Një falenderim i veçantë i bëhet dldp-së, Helvetas Swiss Intercooperation, ekspertëve shqiptar të Co-Plan (Instituti për Zhvillimin e Habitatit) dhe ISB (Instituti i Studimeve Bashkëkohore), NjQV-ve shqiptare të cilat testuan programin, ekspertëve të Ministrisë së Financave dhe HSLU-së.

Stefan Pfaeffli & Alex Loetscher

Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	5
2. Përshkrim i përgjithshëm	9
3. Përpunimi i tabelave të të dhënave	11
3.1 Titulli (A1)	11
3.2 Informacion i përgjithshëm (B1)	11
3.3 Programet (B2)	11
3.4 Organizimi (B3).....	12
3.5 Struktura Funktionale (B4)	13
3.6 Shpenzime Viti i Kaluar (C1)	14
3.7 Të ardhura Viti i kaluar (C2)	15
3.8 Tavanet (D1)	17
3.9 Parashikimet Makro-ekonomike (D2).....	18
3.10 Parashikimi i të ardhurave I: Taksat (E1)	19
3.11 Parashikimi i të ardhurave II: Tarifat (E2)	22
3.12 Parashikimi i të ardhurave III: Gjobat (E3).....	23
3.13 Parashikimi i të ardhurave IV: Të tjera (E4)	24
3.14 Parashikimi i të ardhurave nga grantet (E5).....	25
3.15 Formularë Kërkesë Buxhetore BRF (B1 - B22)	25
4. Mbledhja dhe interpretimi i të dhënave (F1 - F16).....	34
5. Lista e termave teknike dhe shkurtimeve	36

Figurat

Figura 1: Tabela me ngjyra që pasqyrojnë fletë të niveleve të ndryshme	9
Figura 2: B3 - Organizimi	13
Figura 3: B4 – Struktura funksionale	14
Figura 4: C1 – Shpenzimet e vitit të kaluar	15
Figura 5: C2 – Të ardhurat e vitit të kaluar.....	16
Figura 6: D1 - Tavanet.....	18
Figura 7: D2 - Parashikimet Makro-ekonomike	19
Figura 8: E1 - Taksat	20

Figura 9: E2 - Tarifat	23
Figura 10: E3 - Gjobat	24
Figura 11: E4 – Të tjera.....	25
Figura 12: Ekstrakt i formatit C2 – informacione specifike të nevojshme për formularin E4	25
Figura 13: B1 deri në B22 – Formatit kërkesa buxhetore.....	28
Figura 14: Pasqyra e shpenzimeve për çdo aktivitet/projekt.....	29
Figura 15: Pasqyra e të ardhurave sipas formatit për kërkesë buxhetore.....	32

Tabela

Tabela 1: Llojet e fletëve të llogaritjes dhe karakteristikat e tyre	9
Tabela 2: Treguesit Financiar	35

2. Përshkrim i Përgjithshëm

Në fund të fletëve të ekselit, do të gjeni ikonat të cilat ju lejojnë të shkoni nga njëra faqe në tjetrën. Këto ikona kanë ngjyra të ndryshme dhe secila ngjyrë përfaqëson një lloj të ndryshëm flete siç paraqitet në Figurën 1.

Figura 1: Tabelat me ngjyra paraqesin lloje të ndryshme fletësh



Në Tabelën 1 paraqiten lloje të ndryshme fletësh. Mund të bëjmë dallimin midis fletëve hyrëse (fletët ku hidhen të dhënat) dhe fletëve dalëse (fletët ku prodhohen të dhënat e ardhura nga fletët hyrëse). Fletët hyrëse duhet të plotësohen në mënyrë manuale ndërsa fletët dalëse prodhohen në mënyrë automatike nga IPF-ja. Për fletët hyrëse, duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë përgjegjësia për gjenerimin dhe plotësimin e informacioneve Brenda formatit të fletës. Përgjegjësitë e treguara në Tabelën 1 mund të përdoren si një zgjidhje automatike e problemit për të procesuar në mënyrë korrekte dhe në kohën e duhur formatin e fletëve.

Tabela 1: Llojet dhe karakteristika e fletëve

Kodi	Ngjyra e ikonës	Përmbajtja e Fletës	Karakteristika e Fletës	Përgjegjësia për hedhjen e të dhënave
A1	jeshile	Faqja e kopertinës	Fletë dalëse / vetëm për lexim	-
B1-B4	blu e hapur	Struktura e Buxhetit dhe Organizimi	Fletët hyrëse	Departamenti i Financave/ Buxhetit
C1-C2	portokalle	Shifrat e vitit të fundit	hyrëse	Departamenti i Financave/ buxhetit
D1&D2	vishnje e lehtë	Instruksione buxhetore (tavanet dhe parashikimet makro-ekonomike)	hyrëse	Departamenti i Financave/ Buxhetit
E1-E5	argjend	Parashikimi i të ardhurave	hyrëse	Departamenti i Financave/ Buxhetit /Taksave

BRF1-BRF22	e kuqe	Formularë Kërkesë Buxhetore	hyrëse	Departamentet e Linjës/ buxhetit
F1 & F2	jeshile	Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve bruto (tabela)	dalëse	-
F3	jeshile e lehtë	Pasqyra e shpenzimeve bruto për çdo funksion (grafik)	dalëse	-
F4	jeshile	Pasqyra e shpenzimeve neto për çdo funksion (tabelë)	dalëse	-
F5	jeshile e lehtë	Pasqyra e shpenzimeve neto për çdo funksion (grafik)	dalëse	-
F6	jeshile	Pasqyra e shpenzimeve bruto për çdo program (tabelë)	dalëse	-
F7	jeshile e lehtë	Pasqyra e shpenzimeve bruto për çdo program (grafik)	dalëse	-
F8	jeshile	Pasqyra e shpenzimeve neto për çdo program (tabelë)	dalëse	-
F9	jeshile e lehtë	Pasqyra e shpenzimeve neto për çdo program (grafik)	dalëse	-
F10	jeshile	Pasqyra e shpenzimeve bruto për lloj aktiviteti (tabelë)	dalëse	-
F11	jeshile e lehtë	Pasqyra e shpenzimeve neto për lloj aktiviteti (grafik)	dalëse	-
F12	jeshile	Pasqyra e shpenzimeve bruto, klasifikim ekonomik (tabelë)	dalëse	-
F13	jeshile e lehtë	Pasqyra e shpenzimeve bruto, klasifikim ekonomik (tabelë)	dalëse	-
F14	jeshile	Statistikat e Përgjithshme Financiare	dalëse	-
F15	jeshile	Tregues Fiskal	dalëse	-
F16	jeshile	Kontrolli i Mospërputhjes	dalëse	-
G1	e verdhë e fortë	Përkthyes	hyrëse	Përkthyes

3. Përpunimi i tabelave hyrëse

Për secilën nga llojet e ndryshme të tabelave hyrëse jepen më poshtë instruksione të detajuara. Manuali shpjegon logjikën/racion e tabelës dhe për më tepër jep instruksionet e nevojshme për plotësimin e saj. Vetëm vendet e nënvizuara me të verdhë ose në mënyrë opsionale me ngjyrë ulliri kanë nevojë të plotësohen me informacion.

3.1. Titulli (A1)

Formati “Titulli A1” gjenerohet në mënyrë automatike. Nuk kërkohen të dhëna hyrëse. Në fakt kjo është tabela e parë dalëse. Që në këtë pjesë të dokumentit dhe në vijim do të jepet rendi logjik i formateve të përdorura në IPF.

3.2. Informacion i Përgjithshëm (B1)

Formati “B1 Informacion i Përgjithshëm” është i nevojshëm për të përcaktuar periudhën e planifikimit. Ky informacion do të përdoret për të përpiluar të gjitha formatet e seksioneve nga C tek F si dhe për fletën e titullit. Pjesa e poshtme e formatit përdoret për të kompletuar titullin e faqes.

3.3. Programet (B2)

Formati “Programet B2” është i nevojshëm për të përcaktuar strukturën e programit të një NjQV-je specifike. Në programin IPF, ka vend maksimalisht për 16 programe. Ju lutem përdorni tituj të kuptueshëm dhe identifikues si emra programi! Vendosni në mënyrë korrekte emrin e programit dhe emrin e personit përgjegjës të programit në fushat e posaçme të nënvizuara me të verdhë! Ky informacion përdoret për të gjeneruar një sërë formatesh hyrëse dhe dalëse. Plotësime të paplota ose të pasakta të informacioneve në këtë fazë nuk mund të korigjohen në formatet e mëtejshme. Nuk është e mundur të shkruash mbi fushat e nënvizuara me ngjyrën blu.

Formati B2 plotësohet nga Departamenti i Financës. Ju lutem plotësoni vetëm fushat e verdha të këtij formati!

Sugjerim i veçantë: në formularët e kërkesave buxhetore ka vend vetëm për tre aktivitete të çdo fushe të programuar. Nëse ky vend nuk është i mjaftueshëm atëherë ju lutem hapni të njëjtin program dy herë në formatin B2, duke i vendosur të parit indeksin 1 dhe të dytit indeksin 2! Megjithatë, nëse është e mundur,

merrni parasysh edhe përmbledhjen e aktiviteteve të programuara në mënyrë që të limitoni numrin e tyre në tre aktivitete për çdo program.

3.4. Organizimi (B3)

Formati “Organizimi B3” paraqitet në Figurën 2; ky format ju duhet për të përcaktuar përmbajtjen e një programi në kuptimin e funksioneve të NjQV-ve. Klasifikimi i funksioneve në Shqipëri përcaktohet nga Ministria e Financave, këto funksione janë të standartizuara në mbarë vendin, domethënë qartësisht të përcaktuara nga ligji. Do të gjeni këto funksione në rreshtat A dhe B të Figurës 2. Dy funksione janë rezervuar për përdorim opsional, domethënë funksionet 18 dhe 19. Për këtë arsye, funksionet nga 1 deri në 17 dhe nga 20 deri në 22 janë të nënvizuara me të verdhë. Nëse një NjQV dëshiron të përdorë këto funksione jo të detyrueshme duhet të vendosë një titull të kuptueshëm për ti identifikuar ato.

Qëllimi kryesor i formatit B3 është të krijojë lidhjen midis programeve dhe funksioneve. Programi është një kategori më e gjerë se një funksion. Çdo program përfshin një ose më shumë funksione; një funksion i përket vetëm një programi. Për të lidhur programet me funksionet duhet vetëm të shkoni tek fushat e programit në rreshtat nga F tek G. Klikoni në butonin në formë shigjete në të djathtë të fushave me të verdhë të rreshtit G dhe zgjidhni programin e përshtatshëm nga lista. Kjo listë gjenerohet automatikisht nga formati B2. Emrat e programeve shtohen automatikisht në rast se e keni plotësuar në mënyrë korrekte formatin B2. Edhe numri i programit shtohet gjithashtu automatikisht. Mos shkruani emra brenda programit në fushat e verdha të rreshtit G duke shtypur sipër tyre! Në rast se veproni kështu një mesazh me fjalën “Gabim” do të shfaqet në ekran. Mund vetëm të zgjidhni emrat nga kutitë!

Në mënyrë që plotësimi i këtij formati të jetë i plotë, përcaktoni njësitë administrative përgjegjëse për funksionin dhe shkruani emrin e kryetarit të njësisë administrative në rreshtat D dhe E. Ky informacion do të përdoret për Formatin e Kërkesës Buxhetore.

Sugjerim: Kontrolllo formatet e Kërkesës Buxhetore për të verifikuar nëse emrat e njësisë administrative janë ndarë në mënyrë korrekte në Formatet e Kërkesës së Buxhetit. Në rast se ndarjet nuk janë në rregull, mund të bëni rregullimet në formatin B3. Mund të gjeni një shembull në fushën D6.

Departamenti i Financave/Buxhetit do të plotësojë formatin B3.

Figura 2: B3 - Organizimi

E verdhë = plotësohet nga Departamenti i Financës

(B3) STRUKTURA ORGANIZATIVE						
Numri	Funksioni	Njësia administrative	Përgjegjësi i funksionit	Programi përkatës	Emri i programit	Përgjegjësi i programit
Funksioni 1	Administrata e Përgjithshme	Adam	Anna	Programi 13	Mjedis	M
Funksioni 2	Pastrimi dhe gjelbrimi			Programi 4	transporti publik	D
Funksioni 3	Kanalizime ujërave të zeza			Programi 4	transporti publik	D
Funksioni 4	Menaxhimi i rrugëve			Programi 4	transporti publik	D
Funksioni 5	Transporti publik			Programi 3	arsim	Cederik
Funksioni 6	Zhvillimi i turizmit			Programi 4	transporti publik	D
Funksioni 7	Planifikimi urban dhe strehimi	Max	Till	Programi 5	planifikimi urban	E
Funksioni 8	Ndriçimi publik			Programi 4	transporti publik	D
Funksioni 9	Zhvillimi ekonomik			Programi 4	transporti publik	D
Funksioni 10	Pyjet			Programi 4	transporti publik	D
Funksioni 11	Mjedisi			Programi 4	transporti publik	D
Funksioni 12	Sporti			Programi 13	mjedis	M
Funksioni 13	Programe kulturore			Programi 4	transporti public	D
Funksioni 14	Kujdesi social			Programi 4	transporti publik	D
Funksioni 15	Arsimi			Programi 8	Rinisë dhe sporteve	Hamit
Funksioni 16	Shëndetsia			Programi 5	Planifikimi urban	E
Funksioni 17	Emergjencat civile			Programi 4	Transporti publik	D
Funksioni 18				Programi 4	Transporti publik	D
Funksioni 19				Programi 10	Zhvillimi ekonomik dhe	J
Funksioni 20	Shërbime të tjera publike			Programi 4	Transporti publik	D
Funksioni 21	Shërbimi i borxhit afatshkurtër			Programi 4	Transporti publik	D
Funksioni 22	Shërbimi borxhi afatgjatë	Zorro	Zico	Programi 4	Transporti publik	D

3.5. Struktura Funksionale (B4)

Formati “B4 – Struktura Funksionale” përdoret për të identifikuar aktivitetet/projektet dhe karakteristikat e tyre për çdo funksion. Ky informacion është i nevojshëm për organizimin e Formateve të Kërkesës Buxhetore ashtu si dhe për tabelat e dalëse. Numri i aktiviteteve/projekteve, është i kufizuar në tre për secilin funksion. Me anë të këtij kufizimi IPF-ja mbahet nën kontroll. Ju lutem përmbledhni aktivitetet/projektet nën një funksion, në një mënyrë të arsyeshme që të përmbajë jo më shumë se tre aktivitete për funksion. IPF-ja bën dallimin midis aktiviteteve/projekteve në vazhdim dhe aktiviteteve/projekteve të reja, si dhe midis funksioneve ekskluzive, të përbashkëta dhe të deleguara të NjQV-ve. Do të gjeni një ekstrakt të këtij formati në Figurën 3.

Shkruani tituj kuptimplotë për aktivitetet/projektet në fushat e verdha të rreshtit C të Figurës 3. Zgjidh nga kutitë e rreshtit D në rast se aktivitetet/projektet janë në vazhdim apo janë të reja dhe nga kutitë e rreshtit E në rast se aktivitetet janë pjesë e funksioneve ekskluzive, të përbashkëta apo të deleguara. Duhet vetëm të klikoni butonat me shigjeta në të djathtë të fushave të verdha përkatëse të rreshtave D dhe E dhe mund të bëni zgjedhjen tuaj. Mos u përpuni të shkruani mbi këto fusha duke shtypur informacione. Nëse çdo gjë është plotësuar në mënyrë korrekte do të shfaqet sinjali “OK”!, në rast të kundërt mbishkrimi “PLOTËSIM I GABUAR!” do të shfaqet në ekran.

Ky format do të plotësohet nga Departamenti i Financës/Buxhetit.

Figura 3: B4 – Struktura Funksionale

E verdhë = plotësohet nga Departamenti i Financës				
AKTIVITETET PËR ÇDO FUNKSION				
	Emri i Aktivitetit / Projektit	Aktiviteti / Projekti: në vijim/ I ri në vazhdim / i ri	Aktiviteti / Projekti: I veti/ perbashket/deleguar ekskluziv / i përbashkët / i deleguar	
Funksioni 1	Administrata e Përgjithshme			
Aktiviteti / Projekti 1a	Zyra e Kryetarit të Bashkisë	Aktivitet në vazhdim	funksion të përbashkët	OK!
Aktiviteti / Projekti 1b	Zyra e Regjistrimit	Aktivitet i ri	Funksioni ekskluzive	OK!
Aktiviteti / Projekti 1c	Zgjedhjet	Aktivitet në vazhdim	Funksion i deleguar	OK!
Administrata e Përgjithshme				
Funksioni 2	Pastrimi dhe gjelbrimi			
Aktiviteti / Projekti 2a	D	Aktivitet në vazhdim	funksion të përbashkët	OK!
Aktiviteti / Projekti 2b	E	Aktivitet i ri	Funksioni ekskluzive	OK!
Aktiviteti / Projekti 2c	F	Aktivitet në vazhdim	Funksion i deleguar	OK!
Pastrimi dhe gjelbrimi				
Funksioni 3	Kanalizime ujërave të zeza			
Aktiviteti / Projekti 3a	G	Aktivitet në vazhdim	Funksioni ekskluzive	OK!
Aktiviteti / Projekti 3b	H	Aktivitet i ri	Funksioni ekskluzive	OK!
Aktiviteti / Projekti 3c	I	Aktivitet në vazhdim	Funksion i deleguar	OK!
Kanalizime ujërave të zeza				

3.6. Shpenzime Viti i Kaluar (C1)

Në formatin “C1 – Shpenzimet Viti i Kaluar”, shpenzimet dhe të ardhurat specifike të lidhura me aktivitetin ose projektin janë hartuar në një përmbledhje për vitin e kaluar dhe për këtë vit. Formatu ndjek klasifikimin funksional. Merrni informacionin e vitit të kaluar nga raporti financiar vjetor dhe për vitin aktual nga buxheti vjetor i miratuar ose i ndryshuar nga këshilli bashkiak. IPF-ja kopjon informacionin automatikisht në formatet e kërkesës së buxhetit.

Në radhë të parë, formati C1 kërkon informacione mbi shpenzimet bruto për çdo aktivitet të vitit të kaluar dhe vitit aktual (korrent) dhe në radhë të dytë informacione kërkohe edhe për tarifat dhe të ardhurat me destinacion për çdo aktivitet. Informacioni mbi të ardhurat me destinacion kërkohe sepse IPF do të paraqesë shpenzimet bruto dhe neto për çdo aktivitet në formatet e kërkesave buxhetore. Shembulli në vijim shpjegon logjikën e kësaj ideje. Të marrim si shembull sikur një NjQV përmirëson sistemin e grumbullimit të mbetjeve duke përdorur sistemin e mbledhjes së diferencuar të mbetjeve. Shpenzimet bruto janë 1,000,000 Lekë, tarifat janë 500.000 Lekë, dhe kontributi nga një donator është 200,000 Lekë. Kjo do të thotë që shpenzimet neto janë vetëm 300,000 Lekë. Pse ky informacion është i rëndësishëm? Ndoshta Këshilli kërkon të ketë akses te kostot pa mbledhjen e diferencuar të mbetjeve. Shpenzimet bruto mund të jenë sigurisht më të ulëta, por me shumë mundësi donatori mund të mos dëshirojë të paguajë një kontribut.

Do të gjeni një esktrakt të këtij formati në Figurën 4. Departamenti i Financave/ Buxhetit plotëson vetëm fushat e verdha të formatit C1. Si rrjedhojë, departamentet e linjës do të përdorin informacionin si pikë nisje për planifikimin e buxheteve të tyre.

Figura 4: C1 – Shpenzimet e Vitit të Kaluar

E verdhë = plotësohet nga Departamenti i Financës									
SHPENZIMET: FAKTI VITI I KALUAR DHE PLANI VITI KORENT									
		2011			2012				
		Fakti Viti i kaluar			Viti aktual (buxheti)				
		Shpenzime	Tarifa	Te ardhura me destinacion	Shpenzime	Tarifa	Te ardhura me destinacion		
Funksioni 1	Administrata								
Aktiviteti / Projekti 1a	Zyra e Kryetarit të Bashkisë	2,000	3,000	5,000	3,000	5,000	1,500		
Aktiviteti / Projekti 1b	Zyra e Regjistrimit								
Aktiviteti / Projekti 1c	Zgjedhjet								
Administrata		2,000	3,000	5,000	3,000	5,000	1,500		
Funksioni 2	Pastrimi dhe gjelbrimi								
Aktiviteti / Projekti 2a	D								
Aktiviteti / Projekti 2b	E								
Aktiviteti / Projekti 2c	F								
Pastrimi dhe gjelbrimi		0	0	0	0	0	0		

3.7. Të ardhurat e Vitit të Kaluar (C2)

Në formatin “C2 – Të ardhurat e vitit të kaluar”, të ardhurat e vitit të kaluar dhe të vitit aktual janë hartuar në një përmbledhje. Do të gjeni një esktrakt të këtij formati në Figurën 5. Ky format ndjek klasifikimin konvencional të burimeve të të ardhurave vendore.

Për kategoritë e të ardhurave në vijim, specifikoni çfarë lloj të ardhurash merren në konsideratë dhe plotësoni emrat e këtyre burimeve të të ardhurave në pjesën e verdhë të rreshtit B në rast se zbatohet:

- Taksa të ndara;
- Tarifa;
- Gjoha;
- Të ardhura nga asetet;
- Të ardhura nga ndërmarrjet;
- Transferta të kushtëzuara dhe sponsorizime;
- Grante nga fondi i zhvillimit rajonal;
- Kontribute;
- Kredi/Huamarrje

Shikoni fushat nga B19 tek B22 ose nga B 40 tek B42 si shembull.

Merrni informacionet për vitin e kaluar nga raportet financiare vjetore dhe për vitin aktual nga buxheti i vitit aktual të miratuar nga këshilli bashkiak. Informacioni përdoret si një pikënisje fillestare i vlerësimit të të ardhurave nëpërmjet formateve nga E1 tek E5. Informacioni kopjohet në këto formate në mënyrë automatike.

Departamenti i Financës/Buxhetit duhet vetëm të plotësojë fushën e verdhë të formatit C2.

Figura 5: C2 - Të ardhurat e vitit të fundit

E verdhë = plotësohet nga Departamenti i Financës			
TË ARDHURAT: FAKTI VITI I KALUAR DHE PLANI VITI KORENT			
		2011	2012
		Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)
TAKSA			
Taksa e biznesit të vogël			
Taksa mbi pasurine e paluajtshme/ndertesa		455,000	460,000
Taksa mbi pasurine e paluajtshme/Toka bujqësore			
Taksa e fjetjes ne hotel			
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja			
Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme			
Taksa e rregjistrimit të automjeteve/Taksa e mjetet e perdorura			
Taksa për zenien hapësirave publike			
Vendosje tabele për qëllime identifikimi			
Taksa të përkohshme			
Vendosje tabele për qëllime reklamimi II. (të lëvizshme dhe të palëvizshme)			
Taksa të ndara 1			
Taksa të ndara 2			
Taksa të ndara 3			
Taksa të ndara 4			
Të ardhurat gjithsej nga taksat		455,000	460,000
TARIFA			
Tarifa e pastrimit			
Tarifa e hapësirës publike			
Tarifa e ujit të pijshëm			
Tarifa e ndriçimit publik			
Tarifa e sinjalistikës			
Tarifa e gjelbrimit			
Tarifa e reklamës			
Tarifa e parkimit		25,000	30,000
Tarifa e thertores			
Tarifa për shërbime administrative			
Tarifa për shërbime sociale			
Tarifa për aktivitete sportive dhe kulturore			
Tarifa për shërbime të tjera			
Të ardhurat gjithsej nga tarifat		25,000	30,000
GJOBA			
Gjoba 1	xy	5,000	5,000
Gjoba 2	xy		
Gjoba 3	xy		
Gjithsej gjobat		5,000	5,000

3.8. Tavanet (D1)

Tavanet përdoren nga autoritetet politike, si përshembull Kryetari i NjQV-së dhe Këshilli NjQV-së, si një mjet udhëzues për të përcaktuar në mënyrë strategjike rritjet e buxhetit të departamenteve të linjës. Për këtë arsye tavanet duhet të vendosen nga autoritetet politike në fazën fillestare të procesit të përcaktimit të buxhetit. Tavanet, të cilat miratohen nga Këshillat e NjQV-ve, duhet të ndjekin të njëjtën linjë me prioritetet strategjike të NjQV-ve, bazuar në planin e zhvillimit strategjik ekzistues të PSZH-së. Për më tepër tavanet duhet të respektojnë kufijtë financiar të NjQV-ve. Proçesi i parashikimit të të ardhurave sipas formateve nga E1 deri në E5 do të nxjerr në pah këto kufizime financiare.

Është e rëndësishme që tavanet t'u bëhen të ditura departamenteve të linjës sa më parë të jetë e mundur.

IPF-ja përdor një tavan të përgjithshëm për çdo funksion dhe brenda funksioneve, tre lloje nën-tavanesh janë të përcaktuara; taveni i parë është vendosur për pagën dhe sigurimet shoqërore, i dyti për blerjen e mallrave dhe shërbimeve (konsumi përtej kompensimit të stafit), i treti për investimet kapitale. Ndërsa nën-taveni i parë dhe i dytë janë tavane maksimale në lidhje me konsumin, nën-taveni i tretë përbën një kërkesë minimale të investimit kapital. Taveni i investimit kapital është mbetja e tavanit të përgjithshëm për funksion minus dy tavaneve për konsum. Kur përdoren të tilla tavane, Kryetari i NjQV-së së bashku me Këshillin e njësisë mund të drejtojnë një politikë strategjike të shpërndarjes së burimeve për çdo funksion në përputhje me tavanet e përgjithshme; për më tepër autoritetet politike mund të përcaktojnë prioritetet e investimit dhe të mbajnë nën kontroll shpenzimet e stafit në përputhje me nën-tavanet.

Departamenti i Financës/buxhetit plotëson pjesën e verdhë të formatit D1. Niveli minimal i investimit kapital llogaritet automatikisht. Informacioni mbi tavanet përfshihet automatikisht në Formatin e Kërkesës Buxhetore. Tavanet përcaktohen sipas monedhës kombëtare, domethënë sipas Lekut dhe jo si pjesë relative, p.sh. përqindje e shpenzimeve. Mund të gjeni një ekstrakt të formatit "D1 Tavanet" në Figurën 6.

Ka tre parametra për të përcaktuar tavanet:

- Së pari është absolutisht e nevojshme të kryhet një vlerësim i detajuar dhe i besueshëm i të ardhurave të përgjithshme të NjQV-së për secilin nga vitet e buxhetit afat-mesëm. Ky informacion prodhohet në seksionin e mëtejshëm E të IPF-së.
- Së dyti, NjQV-së i nevojitet një strategji zhvillimi vendore. Vetëm në atë moment tavanet mund të përcaktohen në mënyrë strategjike.
- Së treti duhet të ekzistojë vullneti politik i udhëheqjes në mënyrë strategjike të proçesit të hartimit të buxhetit afat-mesëm dhe atij vjetor.

Figura 6: D1 - Tavanet

E verdhë = plotësohet nga Departamenti i Financës				
(D1) TAVANET				
		2013	2014	2015
F1	Administrata e Përgjithshme			
	Tavani i pagave dhe sigurimeve shoqërore			
	Tavani i shpenzimeve të tjera korrente(përrjashtoj pagat dhe sig. shoq.)			
	Niveli minimal i shpenzimeve kapitale	0	0	0
	Përmbledhje e taveve			
F2	Pastrimi dhe gjelbrimi			
	Tavani i pagave dhe sigurimeve shoqërore			
	Tavani i shpenzimeve të tjera korrente(përrjashtoj pagat dhe sig. shoq.)			
	Niveli minimal i shpenzimeve kapitale	0	0	0
	Përmbledhje e taveve			
F3	Kanalizime ujërave të zeza			
	Tavani i pagave dhe sigurimeve shoqërore			
	Tavani i shpenzimeve të tjera korrente(përrjashtoj pagat dhe sig. shoq.)			
	Niveli minimal i shpenzimeve kapitale	0	0	0
	Përmbledhje e taveve			

3.9. Parashikimet Makroekonomike (D2)

Parashikimet makroekonomike të formatit D2 japin informacion mbi vlerësimin e shifrave të rëndësishme në kontekstin makro-ekonomik, të cilat mund të ndikojnë në buxhetin afat-mesëm. Ky informacion përdoret në çdo fazë të procesit të hartimit të buxhetit, p.sh gjatë përgatitjes së buxhetit, vlerësimit të propozimit të buxhetit dhe miratimit të tij, zbatimit të buxhetit dhe kontrollit të mëtejshëm. Këto vlerësime janë kyçe për procesin e hartimit të buxhetit ndaj ato, përpara se të bëhen zyrtare, duhet të jenë të bazuara në vlerësimet e institucioneve të parashikimeve ekonomike, të kualifikuara dhe gjërësisht të njohura, si dhe duhet të konfirmohen nga nivelet politike, p.sh nga Kryetari i NjQV-së. Në shumë raste vlerësimet mbi parashikimet ekonomike merren nga vlerësimet e përdorura nga Ministria e Financave. Këto vlerësime ju jepen NjQV-ve nga Ministria. Megjithatë rritja ekonomike ose inflacioni mund të jetë më i lartë në zona me rritje ekonomike sesa mesatarja kombëtare. I kundërt mund të jetë rasti i zonave rurale të vendit. Është e rekomandueshme që parashikimet e planifikura të reflektohen dhe rregullohen me maturi sipas realitetit të vendit. Kur parashikimet e planifikuara devijonë nga vlerësimet kombëtare arsyet duhet të shpjegohen.

Ju lutem vini re se parashikimet makro-ekonomike nuk përdoren automatikisht për vlerësimin e të ardhurave ose shpenzimeve. Çdo ent buxhetor duhet ta mbajë këtë fakt në konsideratë dhe të vlerësojë impaktin që kanë tek të ardhurat dhe shpenzimet nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë fenomene të tilla si inflacioni i parashikuar, rritja e ekonomike reale etj.

Departamenti i Financës/Buxhetit do të plotësojë informacionin mbi parashikimet

makro-ekonomike dhe do t'ia njoftojë informacionin të gjitha departamenteve të interesuara të linjës, në rastet kur departamenteve të linjës u kërkohet zmadhimi i buxhetit.

IPF-ja identifikon paraprakisht katër tregues ekonomik; ka vend edhe për tregues shtesë të cilët konsiderohen të rëndësishëm për NjQV-të.

Formati “D2 Parashikimet makroekonomike” paraqitet në Figurën 7.

Figura 7: D2 – Parashikimet Makroekonomik

E verdhë = plotësohet nga Departamenti i Financës					
(D2) PARASHIKIMET MAKROEKONOMIKE					
	2011	2012	2013	2014	2015
	Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)	Buxheti viti t+1	Buxheti viti t+2	Buxheti viti t+3
Norma e inflacionit	3.00%	4.00%	2.40%	2.40%	2.40%
Norma reale e rritjes ekonomike	1.00%	2.00%	2.00%	2.00%	2.00%
Norma e rritjes së pagave (nominale)	3.00%	4.00%	4.00%	4.00%	4.00%
Norma e interesit (3 muaj)					
Norma e interesit (5 vjet)					

3.10. Parashikimi i të Ardhurave I: Taksat (E1)

Formati E1 përdoret për parashikimin e të gjitha llojeve të taksave. IPF-ja ju kërkon që secila taksë të parashikohet individualisht. Sidoqoftë procedura është e njëjtë për secilën nga taksat. Së fundmi kuadri i veprimit të këtij formati janë të ardhurat e përgjithshme nga taksat për secilin vit.

IPF-ja konsideron shtatë faktorë të cilët ndikojnë tek taksat. Shtatë faktorët ndikues jepen në vijim: (1) inflacioni; (2) rritja ekonomike reale; (3) rritja e popullsisë; (4) ndryshimet e legjislacionit të taksave; (5) faktorë të tjerë të

jashtëm, të rëndësishëm dhe me impakt; (6) përmirësimi i përdorimit të taksave si potencial; (7) ndryshimi i normës së taksave.

Për fat të keq informacioni mbi faktorët ndikues nuk është i përsosur; një pjesë e tij mund të jetë marrë nga parashikimet makro-ekonomike, sidoqoftë një pjesë e tij duhet të presupozohet. Kjo është vështirësia e parë. Më pas specialistët e taksave të NjQV-ve duhet të vlerësojnë impaktin e secilit faktor ndikues në secilën taksë. Kjo është vështirësia e dytë. Është e qartë se disa faktorë janë më të rëndësishëm për disa lloje taksash sesa për disa lloje të tjera taksash. Për shembull rritja ekonomike ka shumë mundësi të ketë një impakt pozitiv në taksat e biznesit të vogël, por jo në taksat e tokës bujqësore. Megjithatë, vlerësimi i masës së impaktit mbi një lloj takse kërkon një eksperiencë domethënëse. Përdorimi i aftësive statistikore mund të ndihmojë, por nuk mund të zëvendësojë eksperiencën. Ka vetëm një mënyrë për ta bërë: të bësh prova, të diskutosh mbi vlerësimet e gabuara dhe të mësosh prej tyre.

Në Figurën 9 ju mund të shihni një ekstrakt nga formati “E1- Taksat”; këtu janë paraqitur vetëm dy taksat e para, taksa e biznesit të vogël dhe taksa mbi pasuritë e paluajtshme. Në pjesën e sipërme ju do të gjeni emërtimet e shtatë faktorëve të influencës; fusha e kuadratit është lënë e bardhë. Më poshtë në fushat e verdha ju mund të shkruani impaktin e pritshëm të secilit faktor ndikues në taksën përkatëse për secilin vit.

Figura 8: E1 - Taksat

E verdhë = plotësohet nga Departamenti i Financës												
PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NGA TAKSAT												
	2011	2012	Impakti i inflacionit në %	Impakti i rritjes reale ekonomike në %	Impakti i rritjes së popullsisë në %	Vlerësim i impaktit nga përmirësimi i ligjit mbi taksat në %	Vlerësim i impaktit të faktorëve të tjerë në %	Përmirësimi i përdorimit të potencialit të taksave në %	Ndryshimi i normës së taksave në %	2013	2014	2015
Taksa e biznesit të vogël	0	0								5,000	5,750	6,613
		Buxheti aktual										
		t1										
		t2	10.0%	5.0%								
		t3	10.0%	5.0%			10.0%					
		Vlera bazë e taksës së re					5,000					
		Futja e taksës					t+1					OK!
Taksa mbi pasurine e paluajtshme/ndertesa	455,000	460,000								468,650	478,023	482,803
		Buxheti aktual										
		t1	3.0%									
		t2	2.0%									
		t3	1.0%									
		Vlera bazë e taksës së re					-					
		Futja e taksës										OK!

Të dyja rastet e paraqitura në Figurën 8 janë të ndryshme.

- Taksa e parë, domethënë taksa e biznesit të vogël, është shembull i një takse të krijuar rishtazi. Ju lutem mbani shënim se për këtë taksë nuk ka pasur në vitet e mëparëshme të ardhura, as në vitin e fundit 2011 dhe as në buxhetin aktual të vitit 2012.

Në rastin e një takse të krijuar rishtazi duhet të shënoni vitin kur taksa është futur për herë të parë dhe volumin e pritshëm të vitit të parë. Për këtë qëllim duhet të përdorni fushat me ngjyrë ulliri! Plotësoni volumin e pritshëm për vitin e parë, gjithashtu përcaktoni vitin kur taksa është krijuar duke klikuar në butonin në formë shigjete në të djathtë të fushës ku shënohet viti i krijimit. Në shembullin tonë ky vit është t+1. Jemi aktualisht në vitin t; ky është viti i buxhetit aktual. Prandaj t+1 që këtej e tutje është viti i ardhshëm. Për këtë arsye ju duhet vetëm të kontrolloni impaktin e faktorëve ndikues për vitet t+2 dhe t+3, siç është vepruar në shembullin tonë.

Ju lutem mbani shënim se në shembullin tonë kemi presupozuar se vetëm tre nga faktorët ndikues të taksave, janë të rëndësishme për taksën e biznesit të vogël: inflacioni, rritja ekonomike dhe përmirësimi i përdorimit të taksave si potencial. Rezultatet e vlerësimit për këtë taksë do ti gjeni në kutitë ngjyrë argjendi në anën e djathtë të formatit.

- Taksa e dytë, domethënë taksa mbi pasuritë e paluajtshme, është shembulli i një takse ekzistuese. Të ardhurat nga kjo taksë për këtë vit dhe për vitin aktual në përputhje me pasqyrën vjetore dhe buxhetin aktual, do t'i gjeni në fushën portokalli në linjën e parë të kësaj takse.

Pika e nisjes për të realizuar parashikimin janë shifrat e vitit të kaluar. Kjo shifër ka baza solide. Ajo është nxjerrë nga pasqyrat vjetore. Në kundërshtim, shifra e buxhetit nuk është mjaftueshëm solide, prandaj ne nuk do ta përdorim atë si pikënisje për të bërë parashikimin.

Në shembullin tonë ne presupozojmë se inflacioni është i vetmi faktor ndikues i rëndësishëm. Ne presupozojmë se vlera e ndërtimeve do të rritet për shkak të inflacionit. Kjo rritje e vlerës do të ketë një impakt pozitiv në taksën mbi pasuritë e paluajtshme duke qënë se kjo taksë bazohet në vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme.

Mos harroni të llogarisni përqindjen e zmadhimit të volumit të taksës të vitit buxhetor të krahasuar me shifrën e vitit të kaluar. Në shembullin tonë rezulton një rritje nga 455.000 në 460.000, domethënë 1.1%. Ky hap kërkohet sepse pikënisja jonë për planifikimin është viti i kaluar. Nuk mund të injorojmë vitin buxhetor.

Edhe njëherë, ju mund të gjeni rezultatet e parashikimit për këtë taksë në kutitë ngjyrë argjendi në anën e djathtë të formatit.

Për të gjitha taksat e tjera të mbetura, procedura e parashikimit mbetet e njëjtë.

3.11. Parashikimi i të Ardhurave II: Tarifat (E2)

Formati “E2 Tarifat” përdoret për parashikimin e të gjitha llojeve të tarifave. Ky format është ndërtuar në mënyrë të ngjashme me formatin për parashikimin e taksave. Çfarë shpjeguar më parë është e zbatueshme edhe në këtë rast. Megjithatë, ka vetëm pesë faktorë ndikues të tarifave të cilat merren në konsideratë në këtë rast: (1) ndryshimi i volumit të aktiviteteve; (2) përdorimi i potencialit të tarifave; (3) rregullimet ligjore; (4) faktorë të tjerë; (5) ndryshimi i tarifës për njësi.

Një ekstrakt i formatit E2 paraqitet në Figurën 9. Aty kemi dhënë shembuj të tre parashikimeve.

- Tarifa e pastrimit është përdorur si shembull i një tarife ekzistuese më parë. Edhe njëherë, mos harroni të vendosni rritjen e përqindjes së tarifës gjatë vitit buxhetor kur ajo rritet nga 150.000 në 160.000; është një rritje prej 6.67%.
- Tarifa e hapsirës publike do të futet së shpejti, mbas një viti, dhe ne parashikojmë se kjo tarifë do të prodhojë 50.000 gjatë këtij viti. Përdor fushën me ngjyrë ulliri për të vendosur këtë informacion fillestar. Për vitet në vijim përdor fushën e verdhë. Kur çdo gjë plotësohet në mënyrë korrekte, shfaqet në ekran shenja “OK”. Ne mund ti shohim rezultatet e parashikimit tonë për këtë tarifë në fushën ngjyrë argjendi në anën e djathtë të formatit.
- Gjithashtu tarifa e ujit të pijshëm është një shembull për një tarifë të krijuar rishtazi. Nga ky shembull shfaqet në ekran shenja “PLOTËSIM I GABUAR”. Çfarë shkoi keq? Kur fusim këtë tarifë tek t2, dmth dy vite më vonë, nuk mund të kemi një rritje të kësaj takse në pjesën e verdhë për të njëjtin vit. Kjo nuk do të kishte kuptim. Prandaj fshije këtë rritje dhe korigjo vlerën bazë të kësaj tarife nëse është e nevojshme. Më pas parashikimi do të marrë shënimin “OK”!

Figura 9: E2 - Tarifa

E verdhë = plotësohet nga Departamenti i Financës

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NGA TARIFAT										
	2011	2012	Rritja e pritshme e volumit të aktiviteit në %	Përmirësimi i përdorimit të potencialit të tarifës në %	Vlerësim i impaktit nga përmirësimi i ligjit në %	Vlerësim i impaktit nga faktorët e tjerë në %	Rritja e tarifave për njësi në %	2013	2014	2015
Tarifa e pastrimit	0	0						1,040	1,071	1,135
		Buxheti aktual								
		t1	4.0%							
		t2	3.0%							
		t3	6.0%							
		Vlera bazë e tarifës së re					1,000			
		Futja e tarifës					t+0	OK!		
Tarifa e hapësirës publike	0	0						0	0	0
		Buxheti aktual								
		t1								
		t2								
		t3								
		Vlera bazë e tarifës së re								
		Futja e tarifës								OK!
Tarifa e ujit të pijshëm	0	0						11,000	13,200	15,840
		Buxheti aktual								
		t1	5.0%	5.0%						
		t2	2.0%	10.0%	8.0%					
		t3	5.0%	5.0%	5.0%					
		Vlera bazë e tarifës së re					10,000			
		Futja e tarifës					t+0	OK!		

3.12. Parashikimi i të Ardhurave III: Gjoha (E3)

Praktikisht formati E3-Gjobat ndjek të njëjtën llogjikë si E1 dhe E2. Ju lutem konsultoni instruksionet për formatet E1 dhe E2 në lidhje me pjesën sesi plotësohet formati. Megjithatë, formati E3 merr në konsideratë vetëm dy faktorë ndikues; këta janë parashikimi i rritjes (rritja e frekuencës së gjobave) dhe rritja e gjobës për njësi.

Ka vend për tre lloj gjobash. Ju lutem futini llojet e gjobave në fletë “C2 të ardhurat viti i kaluar”. Në rastin e paraqitur më poshtë në Figurën 10, janë vendosur dy gjoba, një gjobë parkimi dhe një gjobë për ndotje. Sidoqoftë këto janë vetëm shembuj:

Figura 10: E3 - Gjoba

E verdhë = plotësohet nga Departamenti i Financës									
PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NGA GJOBAT									
	2011	2012	Rritja e parashikuar në %	Rritja e gjobave për njësi në %		2013	2014	2015	
xy	5,000	5,000				5000	5000	5000	
		Buxheti aktual							
		t1							
		t2							
		t3							
		Vlera bazë e gjobës së re							
		Futja e gjobës							OK!
xy	0	0				1,100	1,210	1,331	
		Buxheti aktual							
		t1	10.0%						
		t2		10.0%					
		t3	5.0%	5.0%					
		Vlera bazë e gjobës së re				1,000			
		Futja e gjobës				t+0			OK!

3.13. Parashikimi i të Ardhurave IV: Të tjera (E4)

Formati “E4 Të tjera” përdoret për të regjistruar të ardhurat e pritshme nga asetet në formën e shitjes ose lënies/qiradhënies. Për më tepër të ardhurat e pritshme nga ndërmarrjet në pronësi të NjQV-ve janë gjithashtu të regjistruara në formatin E4. Ju lutem identifikoni burimet e posaçme në formatin “C2 të ardhurat e vitit të kaluar”, kutitë nga B40 deri në kutinë B53. Informacioni futet automatikisht në formatin E4. Vetëm shkruani shumën e pritshme në fushat e verdha të posaçme të formatit E4.

Formati E4 paraqitet në Figurën 11 më poshtë dhe përmban edhe shembujt. Ajo përfshin të ardhurat nga asetet, nga ndërmarrjet në pronësi të NjQV-ve si dhe një mbartje potenciale nga viti i kaluar.

Figura 11: E4 – Të tjera

E verdhë = plotësohet nga Departamenti i Financës						
PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NGA ASETET						
	2011	2012		2013	2014	2015
Shitja e ndërtesës	-	-	-			100,000
Shitja e tokës	-	-	-		200,000	
Shitja e pronave të tjera	-	-	-			
Qera e tokës	-	-	-			
Qera e ndërtesës	-	-	-	50,000	50,000	50,000
Gjithsej të ardhurat nga asetet		-	-	50,000	250,000	150,000
PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NGA NDËRMARRJET						
	2011	2012		2013	2014	2015
Të ardhura nga ndërmarrja 1	-	-	-			
Të ardhura nga ndërmarrja 2	-	-	-			
Të ardhura nga ndërmarrje të tjera		-	-			
Gjithsej nga ndërmarrjet		-	-	-	-	-

Në Figurën 12 tregohet si duhet të plotësohet informacioni i kërkuar në formatin C2, si një hap parapërgatitor për të patur një format E4 të kompletuar. Vërej kutitë e verdha të linjave nga 40 deri në 53 dhe krahasoju me Figurën 11!

Figura 12: Ekstrakt i formatit C2 – informacion specifik i nevojshëm për formatin E4

NGA ASETET			
Shitja e ndërtesës			
Shitja e tokës			
Shitja e pronave të tjera			
Qera e tokës			
Qera e ndërtesës			
Gjithsej të ardhurat nga asetet		0	0
NGA NDËRMARRJET			
Të ardhura nga ndërmarrja 1			
Të ardhura nga ndërmarrja 2			
Të ardhura nga ndërmarrje të tjera			
Gjithsej nga ndërmarrjet		0	0

3.14. Parashikimi i të ardhurave nga Grantet (E5)

Përdorni formatin E5 për parashikimin e të ardhurave nga grantet, kontributet dhe huatë. Plotësoni parashikimin tuaj për: (1) grante të pakushtëzuara; (2) grante të kushtëzuara; (3) grante konkurruese nga fondi i zhvillimit rajonal; (4) kontribute nga dhuruesit etj., dhe (5) të ardhurat nga huatë në fushat e verdha të këtij formati.

Formati E5 duhet të përgatitet paraprakisht me anë të formatit C2, në mënyrë të ngjashme me formatin E4 (shiko më sipër). Informacioni paraprak është i nevojshëm për të qartësuar nivelin e ndryshëm të hyrjeve nga grantet e kushtëzuara, grantet konkurruese, kontributet e dhuruesve dhe huatë. Informacione mbi grantet për tre vitet e ardhshme jepen nga Ministria e Financave për çdo vit.

Formati E5 është plotësuar nga Departamenti i Financës. Megjithatë, rekomandohet me vendosmëri që Departamenti i Financës/uxheti të konsultohet me departamentet e linjës në lidhje me vlerësimin e granteve të kushtëzuara, granteve konkurruese dhe kontributeve të dhuruesve. Të dhënat për grantet merren nga Ministria e Financave.

3.15. Formate Kërkesë Buxhetore BRF (B1 - B22)

Formatet e kërkesës buxhetore KB-të, përdoren nga departamentet e linjës/ Buxheti/Financa për të përgatitur kërkesat e tyre buxhetore brenda tavaneve të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak. Në këtë mënyrë procesi i përgatitjes së buxhetit ndërthuret me një proces të detajuar përfundimtar. Rekomandohet vendosmërisht që departamentet e linjave të kenë përgjegjësinë për të procesuar KB-të kur ndihen të shqetësuar. Në atë moment duhet të zhvillohet një proces konsultimi me departamentin e linjës dhe të gjitha palët e interesuara duhet të përfshihen. Kjo procedurë garanton që shqetësimet e praktikantëve të respektohen plotësisht gjatë kohës që përpunohet buxheti; duke vepruar në këtë mënyrë, buxheti bëhet më real dhe është më i kuptueshëm nga linja e parë.

Është thelbësore që departamenteve të linjës tu lihet koha e mjaftueshme për të përgatitur kërkesat e tyre buxhetore referuar udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Në përputhje me klasifikimin funksional, janë gjithsej 22 KB; për secilin funksion përdoret një KB e veçantë. Për të ruajtur gjurmët e informacionit, numri i aktiviteteve/projekteve, është i kufizuar në tre për çdo KB. Ju lutem paraqisni individualisht dy më të rëndësishmet dhe pjesën tjetër paraqitini në formë të përbashkët.

KB-ja përbëhet nga katër fusha (shiko Figurën 13):

- (1) Kreu (rreshti nga 1 deri në 7)
- (2) Përmbledhje e kërkesës buxhetore (nga 9 deri në 20)

(3) Përputhshmëria me tavanet (rreshtat nga 24 deri në 38)

(4) Buxhetet e detajuar për aktivitet/projekt (rreshtat nga 40 deri në fund të faqes). Ju lutem shënoni se Figura 13 nuk e tregon këtë fushë për projektin/aktivitetin e dytë dhe të tretë! Është paraqitur vetëm modeli për aktivitetin/projektin e parë.

(1) Kreu i formatit

Zona e kreut paraqet informacione të përgjithshme të funksionit. Në rreshtin 2 ju do të gjeni emrin e funksionit, departamentin e linjës përgjegjëse dhe emrin përkatës të programit. Në rreshtat nga 3 deri në 7, jepen emrat e aktiviteteve/projekteve të këtij funksioni dhe karakterizohen natyra dhe lloji i tyre. I gjithë ky informacion gjenerohet paraprakisht nga Departamenti i Financave dhe përfshihet automatikisht në KB. Asgjë në këtë fushë nuk bëhet manualisht.

(2) Përmbledhje e kërkesës buxhetore

Zona e përmbledhjes paraqet totalin e shpenzimeve të funksionit në terma bruto dhe neto. Mund të gjeni një ndarje të shpenzimeve bruto sipas klasifikimit ekonomik në tre kategori: paga, shpenzime për mallra dhe shpenzime të blera (konsum që nuk rrjedh nga pagat) dhe investime kapitale. Tarifat dhe të ardhurat me destinacion sjellin ndryshimin midis shpenzimeve bruto dhe neto. Kjo fushë plotësohet në mënyrë automatike. Informacioni i përmbajtur në fushën portokalli rrjedh nga informacioni i mbledhur nga Departamenti i Financës; shifrat në fushën ngjyrë argjendi llogariten bazuar në informacionet në fushën 4 të BRF-së. Asgjë në këtë fushë nuk bëhet në mënyrë manuale.

(3) Përputhshmëria me Tavanet

Në këtë fushë, shpenzimet buxhetore krahasohen me tavanet e vendosura nga Këshilli i Bashkisë/Komunës Tavanet plotësohen automatikisht, bazuar në informacionin e marrë nga formati D1, meqënëse shpenzimet totale të pritshme (rreshti 25), në formën e pagave (rreshti 29), shpenzime të tjera korrente (rreshti 33) dhe investimet kapitale (rreshti 37) janë vetë buxheti i parashikuar në fushën 4 të KB-së. Rreshtat 26, 30, 34 dhe 38 tregojnë nëse tavanet janë respektuar apo jo. Vini re vetëm shenjën “OK!” ose “STOP”!

(4) Buxhet i detajuar për aktivitet/projekt

Sic e kemi përmendur, çdo KB ka vend për deri në tre aktivitetet/projekte. Në rreshtin e titullit që është nënvizuar me ngjyrë të kaltërt (#40, #74 and #108), informacioni i mëposhtëm shtohet në mënyrë automatike: numri i funksionit, emri i funksionit, numri i aktivitetit/projektit.

Poshtë rreshtit të titullit do të gjeni tre nën-fusha:

- (i) Ana e majtë i kushtohet parashikimit të shpenzimeve;
- (ii) Ana e djathtë për parashikimin e të ardhurave;
- (iii) Dhe më poshtë (rreshtat 105 dhe 106), ka vend të mbetur për të dhënë shpjegime.

Figura 13: B1 deri në B22 – Format Kërkesë Buxhetore

Numri	Funksioni	Njësia administrative	Përgjegjësi i funksionit	Emri i programit
Funksioni 1	Administrata e Përgjithshme	Spektori I zhvillimit dhe komunikimit	Adam	mjedis

	Aktiviteti	Natyra	Tipi i funksionit
Aktiviteti / Projekti 1a	Zyra e Kryetarit të Bashkisë	Aktivitet në vazhdim	funksion të përbashkët
Aktiviteti / Projekti 1b	Zyra e Regjistrimit	Aktivitet i ri	Funksioni ekskluzive
Aktiviteti / Projekti 1c	Zgjedhjet	Aktivitet në vazhdim	Funksion i deleguar

PËRMBLEDHJE KËRKESËS BUXHETORE					
	Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)	2013	2014	2015
Pagat dhe sigurimet shoqërore			7,375	7,670	7,976
Shpenzime të tjera korrente (përfshijë roga dhe sigurime shoq.)			-6,734	-7,719	-8,126
Shpenzime kapitale			971	1,866	2,053
PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE	2,000	3,000	1,612	1,817	1,903
PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NGA TARIFAT	3,000	5,000	24,900	24,900	24,900
PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE ME DESTINACION	5,000	1,500	0	0	0
SHUMA NETO E KËRKUAR	-6,000	-3,500	-23,288	-23,083	-22,997

PËRPUTHSHMËRIA ME TAVANET					
			2013	2014	2015
Tavan i përgjithshëm			0	0	0
SHPENZIME TË PARASHIKUARA			1,612	1,817	1,903
Diferenca e tavanit të përgjithshëm (duhet të jetë < 0)		STOP!	1,612	1,817	1,903
Tavani për pagat dhe sigurimet shoqërore			0	0	0
Pagat dhe sigurimet shoqërore			7,375	7,670	7,976
Diferenca tavanit të pagave dhe sigurimeve shoq. (duhet të jetë < 0)		STOP!	7,375	7,670	7,976
Tavani i shpenzimeve të tjera korrente			0	0	0
Shpenzime të tjera korrente (përfshijë pagat dhe sigurimet shoq.)			-6,734	-7,719	-8,126
Diferenca e tavanit për shpenzimet e tjera korrente (duhet të jetë < 0)		OK!	-6,734	-7,719	-8,126
Minimumi shpenzimeve kapitale			0	0	0
Shpenzime kapitale			971	1,866	2,053
Diferenca e minimumit të shpenzimeve kapitale (duhet të jetë > 0)		OK!	971	1,866	2,053

Funksioni 1	Administrata e Përgjithshme	Aktiviteti / Projekti 1a	Zyra e Kryetarit të Bashkisë
-------------	-----------------------------	--------------------------	------------------------------

PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE					
	Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)	2013	2014	2015
Shpenzime për aktivitet, viti i parë	OK!				
Inflacioni		5.0%	5.0%	7.0%	8.0%
Ndryshime strukturore të parashikuara		5.0%	5.0%	7.0%	8.0%
Rritje efiçence e pritshme			-10.0%		
SHPENZIME TË PARASHIKUARA	2,000	3,000	2,200	2,508	2,909
KOSTO DIREKTE PËR PROJEKTE & SHPENZIME KAPITALE					
Pagat	600		10,000	10,000	10,000
Sigurimet shoqërore	601		900	910	920
Mirëmbajtje	602		9,000	9,000	9,000
Shpenzime të tjera korrente	603				
Transferta të brendshme	604				
Transferta të jashtme	605				
Transferta të tjera	606				
Shpenzime kapitale	230 / 231		50,000	50,000	50,000
Interesa			1,000	1,000	1,000
Të tjera					
SHPENZIME KORRENTE					
Pagat	600		80,000	81,000	82,000
Sigurimet shoqërore	601		8,000	8,100	8,200
Mirëmbajtje	602		20,000	20,000	25,000
Shpenzime të tjera korrente	603				
Transferta	604, 605, 606				
Interesa					
Të tjera	STOP		-176,700	-177,502	-183,211
SHPENZIME TË PARASHIKUARA	2,000	3,000	2,200	2,508	2,909

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NGA TARIFAT					
	Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)	2013	2014	2015
Vlera bazë e tarifës së re	OK!				
Rritja e volumit të aktivitetit në %		10.0%	10.0%	10.0%	10.0%
Përdorimi i përmirësuar i potencialit në %		10.0%	10.0%	10.0%	5.0%
Impakti i vlerësuar i ndryshimeve ligjore në %			20.0%		
Impakti i vlerësuar i faktorëve të tjerë influencues në %					
Rritja e tarifës për njësi %		0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Tarifa për njësi					
VLERËSIM I TË ARDHURAVE NGA TARIFAT	3,000	5,000	5,040	6,048	6,955

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE ME DESTINACION					
	Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)	2013	2014	2015
Transferta të kushtëzuara			50,000	50,000	50,000
Dhurime					
Të ardhura të mbartura					
Burime të tjera (përfshijë gjokat)					
VLERËSIM I TË ARDHURAVE ME DESTINACION	5,000	1,500	50,000	50,000	50,000
PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE	8,000	6,500	55,040	56,048	56,955

SHUMA NETO E KËRKUAR					
	Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)	2013	2014	2015
SHUMA NETO E KËRKUAR	-6,000	-3,500	-52,840	-53,540	-54,046

Le të shohim tani më nga afër nën-fushën (i) parashikimi i shpenzimeve dhe (ii) parashikimi i të ardhurave për çdo aktivitet/projekt!

(i) Pjesa e shpenzimeve të formatit të kërkesës buxhetore

Nën-fusha e parashikimit të shpenzimeve është sërish e ndarë në tre sektorë (shikoni Figurën 14): pjesa e sipërme (rreshti nga 44 deri në 48) përdoret për vlerësimin e shpenzimeve bruto të një aktiviteti/projekti; sektori i mesëm (nga rreshti 55 deri në 60) shërben për vlerësimin e zbrërthyer të kostove të drejtëpërdrejta të projekteve më të mëdha, të tilla si investimet kapitale; së fundmi, sektori i poshtëm (rreshtat nga 61 deri në 69) përdoret për vlerësimin e zbrërthyer e kostove periodike të aktivitetit buxhetor.

Figura 14: Parashikimi i Shpenzimeve për çdo aktivitet/projekt

PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE					
	Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)	2013	2014	2015
Shpenzime për aktivitet, viti i parë	OK!				
Inflacioni		5.0%	5.0%	7.0%	8.0%
Ndryshime strukturore të parashikuara		5.0%	5.0%	7.0%	8.0%
Rritje efiçence e pritshme			-10.0%		
SHPENZIME TË PARASHIKUARA	2,000	3,000	2,200	2,508	2,909
KOSTO DIREKTE PËR PROJEKTE & SHPENZIME KAPITALE					
Pagat	600		10,000	10,000	10,000
Sigurimet shoqërore	601		900	910	920
Mirëmbajtje	602		9,000	9,000	9,000
Shpenzime të tjera korrente	603				
Transferta të brendshme	604				
Transferta të jashtme	605				
Transferta të tjera	606				
Shpenzime kapitale	230 / 231		50,000	50,000	50,000
Interesa			1,000	1,000	1,000
Të tjera					
SHPENZIME KORRENTE					
Pagat	600		80,000	81,000	82,000
Sigurimet shoqërore	601		8,000	8,100	8,200
Mirembajtje	602		20,000	20,000	25,000
Shpenzime të tjera korrente	603				
Transferta	604, 605, 606				
Interesa					
Të tjera		STOP	-176,700	-177,502	-183,211
SHPENZIME TË PARASHIKUARA	2,000	3,000	2,200	2,508	2,909

Shpenzimet e pritshme:

Në rastin e një aktiviteti në vazhdim do të gjeni shpenzimet për këtë aktivitet/projekt, në fushën portokalli në rreshtin 48, si për vitin e kaluar ashtu edhe për vitin aktual. Në rastin e një aktiviteti/projekti të ri duhet vetëm të plotësoni shumën e pritur në fushën e përshtatëshme të nënvizuar me ngjyrë ulliri në rreshtin 44. Kjo shifër shërben si një pikënisje për aktivitetet/projektet e reja. Ajo duhet të bazohet në përshkrimin e detajuar të kostove; ky përshkrim i detajuar duhet të realizohet si një hap paraprak veçmas procesit të planifikimit financiar. Në këtë rast duhet vetëm të plotësoni fushën e mëposhtme të sqarimeve (rreshtat 71-72) ku mund të gjendet informacioni mbi kostot.

Për vitet e ardhshme duhet të plotësoni pritshmërinë tuaj të zhvillimit të shpenzimeve, p.sh rritje apo zvogëlim. IPF-ja pranon tre faktorë ndikues për këtë llogari: inflacioni, ndryshimet strukturore, dhe efijenca e fituar.

- Inflacioni mund të sjellë kosto për shkak të pagave më të larta, kostove më të larta të karburanteve, etj. Megjithatë bëni një vlerësim të kujdesshëm për të gjetur deri në çfarë pike inflacioni është i rëndësishëm! Si ishte në të kaluarën?
- Ndryshimet strukturore përfshijnë një gamë të gjërë faktorësh ndikues, p.sh ndryshime demografike, përmirësimi i standarteve të cilësisë, vendime politike për shërbime të përparuara, etj.
- Efijenca e fituar duhet të përdoret për të rritur vlerën monetare. Burimi i efijencës së fituar mund të bazohet në përmirësimin e proceseve të prodhimit, çmimet më të mira për mallrat dhe shërbimet e blera si efekt i përmirësimit të procesit të prokurimit, dhe nga kostot më të ulta.

Vlerësoni impaktin e secilit prej këtyre faktorëve ndikues mbi shpenzimet e pritshme në vitet e ardhshme dhe plotësoni informacionin në fushën e verdhë të rreshtave nga 45 deri në 47.

Për aktivitetet/projektet në vazhdim, mos harroni të plotësoni ndryshimin midis përqindjes së shpenzimeve të vitit buxhetor me vitin bazë, që është viti i kaluar. Në shembullin tonë shpenzimet priten të rriten nga 177.000 (viti i kaluar) në 197.000 (viti buxhetor). Kjo është një rritje që në përqindje përkon me 11.3%. Ne presupozojmë se 5.3% janë pasojë e inflacionit dhe 6% janë efekt i ndryshimeve strukturore. Viti i kaluar përdoret gjithmonë si një pikënisje nga IPF-ja sepse shifrat e vitit të kaluar janë një bazë më solide sesa shifrat e buxhetit të vitit aktual.

Në rastin e aktiviteteve/projekteve të reja, ku ju përdorni fushën ngjyrë ulliri të rreshtit 44, ju mund të përdorni fushat e verdha më poshtë për të shpjeguar zhvillimin e mëtejshëm të kostove vetëm për vitet mbas futjes së aktivitetit/projektit të ri.

Ju lutem përdorni kutinë e mëposhtme të shpjegimeve për të përshkruar çështje të rëndësishme!

Kostot e drejtëpërdrejta për projektet dhe investimet kapitale kundrejt kostove periodike:

Tani le të kalojmë tek dy sektorët e tjerë të pjesës së shpenzimeve, të cilat kanë të bëjnë me kostot e drejtëpërdrejta të projekteve dhe të investimeve kapitale nga njëra anë dhe me shpenzime të tjera korrente nga ana tjetër. Këto dy fusha të lejojnë të zbërthesh shpenzimet e parashikuara në përputhje me klasifikimin ekonomik. Në rast të investimeve kapitale dhe projekteve të tjera, pjesa e sipërme, d.m.th rreshtat nga 50 tek 60, ka më shumë peshë; në rastin e aktiviteteve në vazhdim pjesa e poshtëme në pjesën më të madhe të rasteve është më e rëndësishme. Sidoqoftë mbani parasysh se edhe investimet kapitale do të shkaktojnë kosto periodike në vitet e ardhshme. Zbërthimi i kostove të projektit dhe të investimeve kapitale nga njëra anë dhe kostove periodike nga ana tjetër është i nevojshëm për shkak të tavanëve dhe të kërkesave të raportimit. Për të dyja këto arsye, një zbërthim në kategori të klasifikimit ekonomik është i nevojshëm.

Ju lutem mbani parasysh që nëse harroni të plotësoni këtë fushë do të hasni probleme me tavanet nëse ky instrument përdoret nga Kryetari i NjQV-së. Për më tepër, IPF-ja nuk do të përfshijë shpenzimet e shpjeguara në kategorinë “të tjera” në rreshtin 68, i cili përdoret si rezervë. Përveç kësaj, informacionet nga dy sektorët e informacioneve të kostove në rreshtat nga 50 deri në 69 përdoren gjithashtu për tabelat dalëse. Kur nuk i plotësoni në mënyrë korrekte këto fusha, detajet mbi planet financiare të bashkuara do të paraqiten në mënyrë jo korrekte, dhe nuk do të jetë e mundur të përdoren të gjitha tabelat hyrëse.

(ii) Pjesa e të ardhurave e formatit të kërkesës buxhetore

Pjesa e të ardhurave e formatit të kërkesës së buxhetit merr në konsideratë dy lloj të ardhurash: tarifave dhe transfertat e kushtëzuara. Të dyja llojet duhet të lidhen drejtëpërdrejtë me aktivitetin/projektin që merret në konsideratë. Nën titullin jeshil, shuma neto e kërkuar rezulton si shuma e mbetur nga shpenzimet e pritshme për këtë aktivitet (ana e majtë e KB-së, rreshti 69) dhe të ardhurat e pritshme në formën e tarifave dhe të të ardhurave të kushtëzuara (shiko Figurën 15).

Figura 15: Parashikimi i të ardhurave në formatin e kërkesës së buxhetit

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NGA TARIFAT					
	Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)	2013	2014	2015
Vlera bazë e tarifës së re	OK!				
Rritja e volumit të aktivitetit në %		10.0%	10.0%	10.0%	10.0%
Përdorimi i përmirësuar i potencialit në %		10.0%	10.0%	10.0%	5.0%
Impakti i vlerësuar i ndryshimeve ligjore në %			20.0%		
Impakti i vlerësuar i faktorëve të tjerë influencues në %					
Rritja e tarifës për njësi %		0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
Tarifa për njësi					
VLERËSIM I TË ARDHURAVE NGA TARIFAT	3,000	5,000	5,040	6,048	6,955

PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE ME DESTINACION					
	Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)	2013	2014	2015
Transferta të kushtëzuara			50,000	50,000	50,000
Dhurime					
Të ardhura të mbartura					
Burime të tjera (përfshi gjobat)					
VLERËSIM I TË ARDHURAVE ME DESTINACION	5,000	1,500	50,000	50,000	50,000

PARASHIKIMI I TE ARDHURAVE	8,000	6,500	55,040	56,048	56,955
-----------------------------------	--------------	--------------	---------------	---------------	---------------

SHUMA NETO E KËRKUAR					
	Fakti Viti i kaluar	Viti aktual (buxheti)	2013	2014	2015
SHUMA NETO E KËRKUAR	-6,000	-3,500	-52,840	-53,540	-54,046

Le t'i hedhim një sy tani parashikimit të tarifave dhe të ardhurave me destinacion!

Për tarifatat ekzistuese pikënisja është vlera e vitit të kaluar e cila do të dalë në pjesën jeshile të rreshtit të sipërm të parashikimit të tarifave. Për tarifatat e reja përdorni pjesën ngjyrë jeshile e cila emërtohet “Vlera bazë e tarifës së re”; plotëso volumin e pritshëm të vitit të krijimit të tarifës.

Për vitet në vijim merren në konsideratë pesë faktorë ndikues: (i) rritja e volumit të aktivitetit; (ii) përmirësimi i përdorimit të potencialit të tarifave; (iii) impakti i rregullimeve ligjore; (iv) impakti i faktorëve të tjerë ndikues; (v) rritja e tarifës për njësi. IPF-ja funksionon në bazë të ndryshimeve të pritshme të përqindjes të tarifës si efekt i këtyre pesë faktorëve ndikues. Bëni vlerësimin tuaj për secilin prej këtyre faktorëve për çdo vit dhe shkruani vlerësimin tuaj mbi impaktin në kutitë e verdha. Për faktorin e fundit ndikues, rritja e tarifës për njësi, ndryshimi i përqindjes llogaritet automatikisht nga IPF-ja. Kjo ndodh kur ju plotësoni tarifën për njësi në kutitë e verdha dhe llogaritja jepet në kutitë ngjyrë argjendi. Kur të keni kompletuar të gjitha vlerësimet tuaja mbi faktorët ndikues dhe mbasi

të keni futur informacionin në kutitë përkatëse të këtij sektori të KB-së, IPF-ja llogarit automatikisht volumin e ri të tarifës për vitet e ardhëshme.

Parashikimi i të ardhurave me destinacion bazohet tërësisht mbi informacionet e NjQV-së dhe departamenteve të saj të linjës. I gjithë informacioni i disponueshëm duhet të përdoret nga ekspertët për të bërë një hamendësim realist të asaj që mund të pritët.

Totali i të dyja burimeve të të ardhurave, tarifave dhe të ardhurave me destinacione mblidhen më pas dhe rezultati shfaqet në kutitë në të djathtë të “Të ardhurat e pritshme”.

Është shumë e rëndësishme për departamentet e linjës që të kenë një ide të qartë të pritshmërive të tyre nga përdoruesit në kuadrin e tarifave dhe nga palët e treta në kuadrin e të ardhurave me destinacion. Sa më e lartë të jetë e ardhura e lidhur me aktivitetin e drejtëpërdrejtë aq më e vogël do të jetë shuma neto e kërkuar. Ju lutem mbani parasysh raportin vijues: Kur ulet intensiteti i një aktiviteti të caktuar atëherë me shumë mundësi shpenzimet për këtë aktivitet do të zvogëlohen gjithashtu. Megjithatë, në shumë raste, gjithashtu edhe tarifa do të pësojë rënie ashtu si dhe të ardhurat me destinacion. Për këtë arsye, nëse zvogëloni një aktivitet në masën, le të themi, prej 20% atëherë shpenzimi mund të bjerë, sipas gjasave, në masën 15% (jo 20% për shkak të kostove fikse). Për më tepër, kur bien të ardhurat nga aktiviteti i drejtëpërdrejtë, kursimet në kuadrin e kërkesës së buxhetit neto janë shumë më të vogla se 20%, ndoshta 10%. Kjo varet nga rëndësia dhe nga rregullimi i të ardhurave të ardhura nga aktiviteti i drejtëpërdrejtë.

Zyrtarët e buxhetit të departamenteve të linjës duhet të kenë parasysh rëndësinë dhe potencialin e të ardhurave të aktivitetit të drejtëpërdrejtë. Ato forcojnë pozitat e departamenteve të linjës dhe kursejnë të ardhurat e drejtëpërdrejta nga taksat e NjQV-ve. Këto kursime rrisin potencialin e NjQV-së për të zhvilluar akoma më shumë shërbimet publike dhe e bëjnë NjQV-në më tërheqëse.

Zyrtarët e buxhetit të departamenteve të linjës dhe të Departamentit të Financës duhet të ulen bashkë dhe të sigurojnë se vlerësimet e departamenteve të linjës mbi të ardhurat që rrjedhin nga aktivitetet e drejtëpërdrejta janë në përputhje me vlerësimet e Departamentit të Financave në lidhje me tarifatat dhe të ardhurat me destinacion. KB-ja e IPF-së ndihmon për ti bërë transparente dhe të krahasueshme vlerësimet e departamenteve të ndryshme të NjQV-ve; kjo është baza për të pasur një planifikim financiar konsistent.

4. Përpunimi i të dhënave dhe interpretimi i tyre (F1 - F16)

IPF-ja prodhon dy lloje të dhënash, tabela dhe grafike. Ikonat e fletëve të tabelave janë të nënvizuara me jeshile të errët; për grafikët ato janë ngjyrë jeshile e lehtë.

IPF-ja prodhon totalisht 10 tabela dhe 6 grafikë, të cilat mund të përdoren drejtëpërdrejtë për qëllime komunikimi. Megjithatë duhet të jeni të kujdesshëm gjatë paraqitjes së këtyre tabelave dhe grafikëve. Bëjeni në mënyrë selektive për një audience më të gjerë. Mos e mbysni audiencën me informacione të tepërta. Zgjdhni grafikët dhe tabelat të cilat ju duken të rëndësishme. Nënvizoni me anë të një komenti cilat janë pikat e rëndësishme që duhen parë dhe duhen njohur për secilin grup të zgjedhur nga ju për prezantim.

IPF-ja paraqet një pamje të përgjithshme të të ardhurave në tabelën F1. Shpenzimet paraqiten në mënyra të ndryshme:

- në përputhje me klasifikimin e funksioneve (F2 to F5);
- në përputhje me klasifikimin e programit (F6 to F9);
- sipas llojit të aktivitetit, d.m.th aktivitete në vazhdim dhe të reja (F10 & F11);
- në përputhje me klasifikimin ekonomik (F12&F13)

IPF-ja paraqet rezultatet e përbashkëta me shifra bruto dhe neto. Shifrat bruto i japin auditorit informacion mbi shumën totale të planifikuar për të shpenzuar. Shifrat neto tregojnë se sa pjesë e kësaj shume do të paguhet me paratë e taksave vendore.

Përveç kësaj IPF-ja paraqet një pasqyrë të përgjithshme financiare (F14), d.m.th të ardhurat totale, shpenzimet totale si dhe fitimet dhe humbjet e përgjithshme.

Së fundmi në fletën F15, IPF-ja llogarit shifrat aktuale për 12 treguesit financiar (shiko Tabelën 2). Këto tregues duhet të përdoren për të vlerësuar nëse plani financiar afat mesëm ka një bilanc të mirë financiar. Për interpretimin dhe vlerësimin e vlerave të treguesve, kërkohet ekzistenca e një strategjie financiare me vlera të qarta objektive të hartuar nga NjQV-ja. Kjo strategji mund të jetë pjesë e SDP-së: sidoqoftë një strategji me sektorë të ndarë duket më e përshtatëshme sepse kjo përjasje ofron fleksibilitet më të madh.

Tabela 2: Treguesit Financiar

Treguesi	Interpretimi i mundshëm
Shpenzime të përgjithshme/të ardhura të përgjithshme	Nëse shpenzimet e përgjithshme janë më të larta se të ardhurat e përgjithshme NjQV-ja ka humbje.
Të ardhura nga taksat / të ardhura të përgjithshme	Sa më i lartë të jetë ky raport, aq më e madhe pavarësia vendire nga njëra anë, por aq më e lartë edhe barra e taksës nga ana tjetër. Ekziston një shkëmbim midis dy shqetësimeve të pavarësisë dhe të barrës së ulët të taksave për qytetarët e qeverisë vendore.
Të ardhurat nga tarifat / të ardhura të përgjithshme	Raporti mund të rritet kur përmirësohet mbledhja e tarifës. Megjithatë, tarifat paguhen më me vështirësi nga qytetarët me të ardhura të ulta.
Të ardhurat nga gjobat, asetet, ndërmarrjet dhe mbetjet e vitit të kaluar / të ardhura të përgjithshme	Luhatja nga njëri vit në tjetrin është e rëndësishme të analizohet.
Të ardhurat e krijuara nga vetë njësia vendore/ të ardhura të përgjithshme	Tregues i pavarësisë dhe fuqisë fiskale të NjQV-së.
Të ardhura nga jashtë / të ardhura të përgjithshme	Tregues i varësisë financiare të NjQV-së.
Të ardhurat nga taksat për banor	Tregues i fuqisë fiskale të NjQV-së dhe i aktivitetit të mbledhjes së taksave.
Të ardhurat nga tarifat për banor	Tregues i orientimit nga tregu i NjQV-së dhe i aktivitetit të mbledhjes së tarifës.
Investim Kapital për banor	Masa e orientimit nga zhvillimi, i financave vendore
Grante të pa-kushtëzuara dhe transferata/ të ardhura të përgjithshme	Tregues i varësisë së NjQV-së
Interesat /shpenzime të përgjithshme	Tregues i barrës së borxheve
Investim Kapital / shpenzime të përgjithshme	Tregues për orientimin ndaj zhvillimit të financave të NjQV-ve

Fleta e fundit dalëse, e quajt papajtueshmëri, është vetëm për përdorim ndërkombëtar. Në këtë fletë parashikimet për të ardhurat e rrjedhura nga aktivitetet ekonomike të drejtëpërdrejta, të bëra nga departamentet e linjës, krahasohen me të njëjtin vlerësim të bërë nga departamenti i finances. Të dyja vlerësimet duhet të përputhen. Në rast se nuk ndodh kështu, ka shumë mundësi që disa informacione mbi të ardhurat mungojnë ose janë të pavërteta, si nga ana e departamenteve të linjës ashtu dhe nga ana e departamentit të finances. Ky element lidhës i cili mungon, duhet të gjehet duke bërë bisedime ndërmjet të dyja palëve, dhe vlerësimi i gabuar duhet të korigjohet derisa të zhiduken mospërputhjet. Së bashku me kontrollin e tavanit, i cili është ndërtuar bazuar në formatet e kërkesës buxhetore, kontrolli për mospërputhje është një mënyrë më shumë për të kontrolluar nëse rezultati i shumës minimale dhe maksimale të buxhetit, përputhen.

Korrekhtësia e tabelave dalëse dhe grafikeve varen nga saktësia dhe gjithëpërfshirja e të dhënave në IPF dhe përkatësisht në fushën hedhjes së të dhënave të IPF-së.

5. Lista e termave teknike dhe shkurtimeve

Termi	Shpjegimi
Aktivitet	proçes i ndërmarrë për të arritur një objektiv të politikës
KB	Formatet e kërkesave buxhetore të përdorura nga departamentet e linjës për të përgatitur një draft buxhet për funksion dhe aktivitet nën përgjegjësinë e tyre
Tavanet	Shuma maksimale për shpenzimet e lejuara për një artikull. IPF përfshin tavanet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none">- Përmbledhje e taveve për program- Tavanet mbi pagat dhe sigurimet shoqërore për program- Tavanet mbi shpenzimet për program (mblerja e mallrave dhe shërbimeve)- Minimumin e investimeve kapitale
Co-Plan	Instituti për Habitatin dhe zhvillimin, Tiranë
Kosto direkte të projekteve	Kosto për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve duke përfshirë menaxhimin e projektit. Shiko gjithashtu kosto periodike.
dldp	Programi për Zhvillim Lokal dhe Decentralizim
Efikasiteti i fituar	Proçedura të përmirësuara mundësojnë uljen e kostove për njësi. Kur NjQV arrijnë të fitojnë efikasitet më tepër të mira dhe shërbime ose aktivitete të reja mund të financohen me më tepër lehtësi.
Indikator financiar	Shifra të rëndësishme financiare të përdorura për të aksesuar qëndrueshmërinë e financave lokale në mënyrë të përmbledhur
IPF IPF	Instrumenti i planifikimit financiar
Funksion	Fushë e përgjegjësisë në sektorin publik, si menaxhimi i mbetjeve dhe pastrimi, ujësjelles kanalizimet, menaxhimi i rrugëve, transporti publik, etj.

PSZH	Plan Strategjik Zhvillimi
Shpenzime bruto	Totali i shpenzimeve duke përfshirë çfarë mbulohet nga paët e treat (tarifat e përfituesve, grantet nga Qeveria, kontributet e donatorëve, etj.). Shiko gjithashtu: shpenzime neto
HSLU	Hochschule Luzern, Universiteti i Arteve dhe Shkencave të Aplikuara Lucerne, Zvicërr
ISB	Instituti Studimeve Bashkëkohore, Tiranë
Parashikime makroekonomike	Planifikim i vlerësimeve mbi zhvillimet ekonomike që prekin financat e NjQV-së gjatë periudhës së planifikimit afat: rritja ekonomike, inflacioni, norma e interesit afatgjatë dhe afatshkurtër, rritja mesatare
Afatmesëm	Tre vitet e ardhshme
PBA	Plani Buxhetor Afatmesëm
MoF	Ministria e Financave
Shpenzime neto	Total i shpenzimeve duke përjashtuar kostot e mbuluara nga të tretët (tarifat e përfituesve të shërbimeve, grantet e Qeverisë, financimet e donatorëve, etj.). Shiko gjithashtu: shpenzime bruto
Program	Fusha e politikës e kombinuar me detyrat që i përkasin një NjQV-je. Programet janë zakonisht më të gjera se funksionet.
FZHR	Fond i Zhvillimit të Rajoneve
Kosto periodike	Kosto të vazhdueshme si efekt i një shërbimi. Shembull: kur ndërtohet një qendër shëndetsore kjo gjatë viteve do të kërkojë staf, ilaçe, ngrohje, etj. Shiko gjithashtu: kostot direkte të projekteve.
SDC	Agjencia Zvicerrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
Ndryshime strukturore	Zhvillime demografike, ligje të reja ose amendamente, procedura të reja etj, që mund të kenë një efekt në shpenzimet e programit.